



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja d të Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 24, paragrafët 1, 2, dhe nenit 25, paragrafët 1, 2 dhe 6 të Ligjit nr. 06/ L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 10/03, prill 2019), dhe nenit 33.2, shkronja a, dhe nenit 34.1, shkronja d, të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. Nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 9.10.2023, merr këtë

V E N D I M

- I. MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Adem (Hazir) Berishës, Hetem (Hazir) Berishës, Fadil (Hazir) Berishës dhe Rustem (Hazir) Berishës.
- II. Prona e paluajtshme komunale që do të jepet në këmbim ka këto karakteristika:**
1. Pjesa e parcelës kadastrale, nr. 00036-0, me sipërfaqe 196 m², Certifikata e pronësisë, nr. P-71914050-00036-0, Zona kadastrale Matičan Prishtinë, në pronësi të P.Sh. Rrugë Publike e të pakategorizuar, me destinim një pjesë e parcelës është ndërtim sipas Planit rregullues "Mati 1", i miratuar me Vendimin nr. 01, nr. 35-18186, dt. 03.08.2005, Vendimit për plotësim- ndryshimin e Planit rregullues "Mati 1", i miratuar me Vendimin nr. 01, nr. 031-1678, dt. 20.07.2011, dhe Plani zhvillimor urban, nr. 01, nr. 035-181427, dt. 24.09.2013.
 2. Kurse prona e paluajtshme që merret nga ky këmbim, është pjesa e parcelës kadastrale nr. 00621-2, sipërfaqja 196 m², Zona kadastrale Matičan Prishtinë, Certifikata e pronësisë, nr. P-71914050-00621-2, në pronësi të Adem (Hazir) Berishës, Hetem (Hazir) Berishës, Fadil (Hazir) Berishës dhe Rustem (Hazir) Berishës, me destinim gjelbërim të planifikuar sipas Planit rregullues të lartcekur.
- III. Këmbimi i pronës së paluajtshme është bërë për shkak të realizimit të Planit rregullues "Mati 1" në Prishtinë, Vendimin për përcaktimin e kushteve ndërtimore 05, nr. 350/02-213352/22, dt. 21.02.2023.**

- IV. Para shpalljes publike të vendimit, do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të pronës së paluajtshme të Komunës dhe vlerësimi i pronës private, ku do të përcaktohen sipërfaqet e sakta të këmbimit.
- V. Mënyra dhe kushtet e këmbimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe pronarit të parcelës kadastrale që do të këmbehet.
- VI. Pronat e paluajtshme komunale që do të këmbehen, të përshkruara në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohen në librat kadastralë të Komunës.
- VII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtorja e Pronës dhe Drejtorja e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.
- VIII. Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë:
- Skica grafike,
 - Kopjet e planit dhe
 - Certifikata e njësisë kadastrale.
- IX. Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-463/03-204141/23, më 10.10.2023

KRYESUESI I KUVENDIT
Pëllumb Bajtinovci



Arsyetim

Drejtoria e Urbanizmit me Vendimin për përcaktimin e kushteve ndërtimore, 05. nr. 350/02-213352/22, dt.21.02.2023, ka dhënë Pëlqimin për këmbimin e pjesës së parcelës kadastrale nr. 36-0, sip. 196m², ZK Matičan në pronësi të P.Sh. rrugë publike e pakategorizuar, e cila gjendet në kuadër të bllokut urban shumë banesor dhe afarist - ndertesa "A21/01", B+P+6, në kuadër të bllokut urban "A 21", Teresia "A" të Planit rregullues "Mati 1", i miratuar me Vendimin, 01. nr. 35-14451, dt. 21.6.2005, Vendimit për plotësim-ndryshimin e Planit rregullues "Mati 1", i miratuar me Vendimin, 01.nr. 35-642, dt. 01.04.2010 dhe PZHU-së me nr. 01. nr. 031-156871, dt. 27.08.2013, dhe pjesën e parcelës kadastrale nr. 621-2, me sip. 196m², ZK Matičan, Prishtinë, në pronësi të Adem (Hazir) Berishës, Hetem (Hazir) Berishës, Fadil (Hazir) Berishës dhe Rustem (Hazir) Berishës, me destinim e perfshire në hapësirë publike gjelbërim.

Propozimi për inicimin e këmbimit të parcelës/ave të tokës me pronarët e cekur në pikën II, është bërë për shkak të realizimit të Planit rregullues "Mati 1" në Prishtinë, Vendimin për përcaktimin e kushteve ndërtimore, 05. nr. 350/02-213352/22, dt. 21.02.2023. Pjesa e parcelës nr. 36-0, Zona kadastrale Matičan, shtrihet në zonë të planifikuar për ndërtim, ndërsa pjesa e parcelës nr. 621-2, me sip. 196m², ZK Matičan, Prishtinë, sipas Planit rregullues "Mati 1", i miratuar me Vendimin, 01. nr. 35-18186, dt.3.8.2005, Vendimit për plotësim-ndryshimin e i Planit rregullues "Mati 1", i miratuar me Vendimin nr. 01nr.35-642, dt.01.04.2010, Vendimit për plotësim-ndryshimin e Planit rregullues "Mati 1" i miratuar me Vendimin, 01nr.031-1678, dt.20.07.2011, dhe Plani zhvillimor urban, 01. nr. 035-181427, dt.24.09.2013, shtrihen në infrastrukturë publike-gjelbërim të planifikuar.

Procedura e këmbimit të pronës komunale me pronë private është duke u zhvilluar në bazë të nenit 25 të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 10/03, prill 2019).

Andaj, duke u bazuar në dispozitat ligjore të cilat janë të përshkruar në pjesën hyrëse të këtij propozimi dhe në shkresat e lëndës, propozojmë që të bëhet këmbimi i pronës komunale me pronë private, siç është përshkruar në pikën II të dispozitivit të këtij propozimi.